

Bazuar në nenin 36 paragrafi 1.17 dhe nenin 65.1 të Ligjit Nr.03/L –209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 Mbi licencimin, Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Kompanive të Sigurimeve dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimeve, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më 22 prill 2014, lëshon këtë:

Udhëzim Nr. 02/2014

Mbi pagesën e primeve të sigurimit përmes sistemit bankar

1. Të gjithë siguruesit, risiguruesit, ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), obligohen t'i implementojnë procedurat e pagesës së të gjitha primeve të sigurimit përmes sistemit bankar, apo pikave të shitjes (Point of Sale – POS), pagesës përmes kartës së kreditit/debitit. Pagesa e të gjitha primeve të sigurimit duhet mundësuar të bëhet duke përdorur cilëndo nga metodat e mëposhtme:
 - a. *Transfer bankar të pagesës për primet e sigurimit në llogarinë bankare të specifikuar për mbledhjen e primeve të kompanisë së sigurimeve.*
 - b. *Pagesën e primeve të sigurimit përmes kartave bankare të kreditit/debitit duke përdorur sistemin e mbledhjes së kreditit dhe debitit, kartelave bankare (POS), ku pagesat do të transferohen në llogarinë bankare të specifikuar për mbledhjen e primeve të kompanisë së sigurimit, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe BKS-së në bankë.*
 - c. *Transfer bankar të pagesës për primet e sigurimit në llogarinë bankare të specifikuar për mbledhjen e primeve të ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe BKS-së.*
2. Ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe BKS-ja, duhet të kenë marrëveshje të shkruar me secilin sigurues që ata e përfaqësojnë, gjë e cila do t'u jepte atyre autoritetin për t'i mbledhur primet nga policëmbajtësit në emër të siguruesit dhe pagesat për ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe BKS-në do të jenë të njëjta si pagesat e bëra për siguruesit.

3. Është përgjegjësi e siguruesve, risiguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe BKS-së, që paraprakisht të krijojnë infrastrukturën e nevojshme teknike, në mënyrë që t'i thjeshtësojnë dhe qartësojnë të gjitha procedurat e pagesës së primeve të sigurimit përmes këtyre sistemeve për policëmbajtësit e tyre.
4. Formulari për transfer bankar, përfshirë të gjitha informatat e nevojshme standarde do t'i jepen paraprakisht klientit për të kryer pagesën e primeve të sigurimit përmes sistemit bankar, ndërsa klienti është i obliguar që vetë ta bëjë pagesën dhe të sjellë dëshminë e pagesës përmes bankës në rastet kur pagesa është bërë përmes bankës apo POS-it.
5. Është përgjegjësi e kompanive të sigurimeve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe BKS-së që t'i përgatisin menjëherë manualët dhe procedurat për të informuar dhe trajnuar personelin dhe ndërmjetësit e sigurimeve, të cilët janë të përfshirë në shitjen e produkteve të sigurimeve, në lidhje me implementimin e këtij Udhëzimi, për pagesat e primeve të sigurimit qoftë përmes bankës apo POS-it.
6. Ky Udhëzim lejon pagesën e policës së sigurimit në para të gatshme maksimum në vlerë prej 10 euro, por që mjetet e grumbulluara në fund të ditës duhet të deponohen në bankë. Në ndërkohë ndalon rreptësisht pagesën e të gjitha primeve të policave të sigurimit në para të gatshme në tejkallim të shumë prej 10 euro. Si përjashtim nga ky paragraf, Byroja Kosovare e Sigurimeve mund të lejoj pagesën e primit për policat kufitare edhe në vlerë mbi 10 euro, mirëpo në raste të tilla obligohet që të gjitha paratë e gatshme të grumbulluara gjatë ditës nga shitja e policave kufitare t'i deponoj në bankë në fund të ditës.
7. Pagesa e polices së sigurimit mund të bëhet edhe përmes kartelës së kreditit apo debitit që nuk është në emër të policëmbajtësit por me kusht që poseduesi i kartelës së kreditit/debitit të mos jetë person i ndërlidhur me siguruesin, ndërmjetësuesin e sigurimeve dhe me BKS-në.
8. Ndërmjetësuesi i sigurimeve mund të lëshoj policën e sigurimit vetëm pasi të pranoj konfirmimin bankar mbi pagesën e primeve të sigurimit. Pagesa e primeve të sigurimeve përmes sistemit bankar mund të bëhet edhe me këste, vetëm nëse kështu është përcaktuar me kontratën e sigurimeve midis siguruesit dhe policëmbajtësit.
9. Për shkak të Ligjit të Lizingut 03/L-103, Neni 11 për sigurimet, në Kosovë, Lizingdhënësi lejohet të paguaj primin e sigurimit për Lizingmarrësin nëse ai nuk e bën këtë dhe në rast të tillë, me dëshminë e pagesës për këtë sigurim, Lizingmarrësi duhet të rimbursion menjëherë Lizingdhënësin për koston e shkaktuar në lidhje me këtë sigurim. Për këtë arsye Paragrafi 5 i këtij udhëzimi nuk aplikohet për policat e sigurimit që sigurojnë asetet nën kontratë të lizingut.
10. Përveç policës origjinale të sigurimit, klienti duhet të prezantoj dëshminë e pagesës të primeve të sigurimit të automjetit te qendra e regjistrimit të automjeteve.

11. Siguruesi i emëruar në dokumentet e policës që kanë të bëjnë me pagesën e premive pranon pagesën e bërë për ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe BKS-në si dëftesë për pagesën e primit për policën në fjalë.
12. Ky Udhëzim zëvendëson Udhëzimin e datës 27 Shtator 2013 mbi pagesën e primeve të sigurimit përmes sistemit bankar.
13. Ky Udhëzim është efektiv nga data 1 maj 2014.



Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv